



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA**  
**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**  
**MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA**  
**SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA**



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), te Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe konform nenit 15 dhe 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, ---, miratoi këtë:

**Projket-V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve nga Komuna e Suharekës për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, me këtë përbërje:

1. ----- i/e emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
2. ----- i/e emëruar nga Kuvendit Komunës-----anëtar/e
3. -----i/e emëruara nga Kryetari Komunës-----anëtar/e

**Neni 2**

Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë të përcaktuar me Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012” i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009 dhe me Ligjin Nr-06/L-016, për shoqëritë tregtare “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/2018” dhe ligjet tjera që janë në fuqi.

**Neni 3**

3.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, me seli në Suharekë.

3.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

**Neni 4**

4.1 Mandat i anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

4.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kur do herë që kërkohet.

**Neni 5**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Me datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI